Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca
Office of the Chief State Prosecutor

BULETINI MUJOR

BULETINI I PROKURORIT TË SHTETIT

JANAR 2021

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit
Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca
Office of the Chief State Prosecutor

Buletini i Prokurorit të Shtetit

Janar 2021

Përmbajtja

FJALA HYRËSE E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT 5

Aktivitetet e Prokurorit të Shtetit, janar 2021 6

PROKURORI I SHTETIT
DRŽAVNI TUŽILAC

FJALA HYRËSE E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me qëllim të rritjes së transparencës së institucionit të Prokurorit të Shtetit ka përgatitur dhe publikuar Buletinin njëmujor.

Opinioni publik do të ketë mundësi të informohet edhe përmes këtij Buletini për aktivitetet e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe të prokurorive të Republikës së Kosovës.

Si Kryeprokuror i Shtetit jam i përkushtuar të vazhdojmë punën dhe angazhimin që institucioni i Prokurorit të Shtetit të realizojë të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë, të cilat burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet tjera në fuqi.

Prokurori i Shtetit përmes publikimit të Buletinit njëmujor ka për qëllim që ta mbajë të informuar opinionin e gjerë publik, duke përfshirë qytetarët, mediat dhe shoqërinë civile për punën e gjithë institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Ju faleminderit!
Aleksandër Lumezi
Kryeprokuror i Shtetit

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Aktakuzë kundër pesëmbëdhjetë personave

Prishtinë, 11 janar 2021 – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Speciale, kundër pesëmbëdhjetë (15) të pandehurve me inicialet A.K, A.K, I.V, B.I, S.F, F.M, A.D, Xh.K, E.J, B.H, N.E, H.K, K.M, T.B, D.R , për veprat penale "Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm", nga neni 300 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1, të Kodit Penal Republikës së Kosovës (KPRK-së), "Kontrabandimi i Mallrave", nga neni 317 paragrafi 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), "Shmangie nga tatimi", nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), dhe "Shpëlarje e parave", në kundërshtim me nenin 302, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr.06/L-074), lidhur me nenin 56 (1) (1.5) të Ligjit Nr.05/L-096 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit".

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Kërkohet paraburgim ndaj një personi për vrasje të rëndë

Gjilan, 17 Janar 2021– Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit nga Gjykata Themelore në Gjilan, ndaj të pandehurit D.I., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale ''Vrasja e rëndë'', të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas kërkesës, dyshohet se më 15 Janar 2021, rreth orës 20:40 minuta, në fshatin Izvor Komuna e Novobërdës, i pandehuri D.I., ka privuar nga jeta tani të ndjerin K.I., në atë mënyrë që e ka goditur 12 herë me thikë në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse. Me këto veprime, i njëjti dyshohet se ka kryer veprën penale të sipërshënuar.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Pas informacioneve të pranuara dhe raporteve në media lidhur me futjen potenciale të vaksinave anti-COVID në pjesën veriore të Kosovës pa përfillur dispozitat e zbatueshme ligjore, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, në bashkëpunim të ngushtë me policinë, janë duke mbledhur informacione për të vlerësuar nëse vaksinat janë sjellë në Kosovë, si dhe nëse importimi i tyre është bërë në pajtim me protokollet përkatëse për mbrojtjen e shëndetit publik dhe kërkesat ligjore që rregullojnë këto çështje.

Ne sigurojmë publikun se mbetemi syhapur në zbulimin, hetimin dhe ndjekjen e veprimeve të kundërligjshme që mund të rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë publike, si dhe mbetemi të përkushtuar që të sigurojmë që askush të mos shfrytëzojë situatën e krijuar si rezultat i pandemisë gjatë kësaj kohe kritike.

Prokuroria do ta mbajë publikun të njoftuar në vazhdimësi me zhvillimet.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Ferizaj, 22 Janar 2021 – Prokuroria Themelore në Ferizaj, njofton opinionin publik se sot me datë 22 Janar 2021, rreth orës 14 e 20 minuta, me urdhër të prokurorit, ka lëshuar vendim për ndalim, ndaj të dyshuarit J.B, nga Kaçaniku- i dyshuar për disa vepra penale të Vjedhjes së rëndë.

Vlen të ceket se personi në fjalë, me datë 20 Janar 2021, është liruar nga ndalimi për faktin se është bërë një plan operativ hetimor nga ana e organeve të ndjekjes.

Sa i përket shkrimeve në media të ndryshme se i pandehuri është liruar, kjo ka ndodhur për shkak të arsyeve të lartëcekura.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Fjalimi i Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve

Prishtinë, 22 janar 2021

Shkëlqesia Juaj, znj, Vjosa Osmani, U.D. Presidente e Republikës së Kosovës,

Të nderuar kryeprokurorë, prokurorë, punonjës të sistemit prokurorial,

Të nderuar Shkëlqesi Ambasadorë dhe përfaqësues të misioneve diplomatike të akredituara në Republikën e Kosovës,

Të nderuar drejtues të institucioneve vendore,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Është kënaqësi t'iu përshëndes dhe t'iu falënderoj për pjesëmarrjen virtuale në Konferencën Vjetore të Prokurorëve të Shtetit, e cila këtë vit po zhvillohet në mënyrë jo të zakonshme për shkak të situatës me

Covid-19. Ashtu sikurse në vitet e kaluara, edhe periudha e fundit dymbëdhjetë mujore ishte përplot me sfida dhe vështirësi.

Për fat të keq, ne humbëm edhe (3) kolegë prokurorë, të cilët me zell, përkushtim, profesionalizëm dhe integritet i shërbyen institucionit të Prokurorit të Shtetit, duke na lënë një dhimbje dhe zbrazëti të madhe brenda sistemit tonë.

Megjithatë, nga numri i madh i sfidave dhe vështirësive nëpër të cilat kemi kaluar, është thelbësor fakti që kemi treguar se jemi të gatshëm dhe të aftë të veprojmë në mënyrë adekuate, duke iu përgjigjur me sukses nevojave të kohës, ku edhe përkundër rrethanave të shkaktuara nga pandemia Covid-19, puna e Prokurorit të Shtetit nuk u ndalua për asnjë moment, duke i kryer kështu me përgjegjshmëri detyrat institucionale të përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Për ta dëshmuar këtë, theksoj faktin se gjatë vitit 2020, Prokurori i Shtetit ka pranuar në punë 43 mijë e 446 kallëzime - lëndë penale, ndërsa ka arritur t'i zgjidhë 49 mijë e 381 lëndë penale. Respektivisht, janë zgjidhur edhe 5 mijë e 935 kallëzime – lëndë penale të bartura nga vitet paraprake.

Bazuar në indikatorët e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), numri i lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuara gjatë kësaj periudhe, rezulton që norma e zgjidhjes së lëndëve nga Prokurori i Shtetit është 113,66%.

Edhe gjatë vitit që e lamë pas, ne kemi qenë unikë, duke treguar forcën tonë që e përbëjmë të gjithë së bashku si Prokurori e Shtetit, si dhe kemi dëshmuar vendosmëri për t'u përballur me çdo formë të krimit dhe në këtë rrugë nuk do të na ndalë askush, sepse ky është interesi i shtetit dhe ne veprojmë në emër të shtetit.

Sipas urdhrave të Prokurorisë janë ndërmarrë masa dhe veprime, të cilat kanë rezultuar me zbardhjen e veprave penale më të rënda, ndërsa janë privuar nga liria dhe janë proceduar shumë pjesëtarë të grupeve kriminale. Në këtë mënyrë, kemi dërguar porosi të qarta te të gjithë se askush nuk mund të vihet mbi institucionet e shtetit.

Shoqëria me të drejtë është duke pritur nga prokurorët që nëpërmjet hetimeve të mirëfillta dhe të paanshme të kontribuojnë në pastrimin e shtetit, politikës dhe institucioneve nga korrupsioni, nepotizmi,

abuzimi dhe çdo formë tjetër e krimit që i cenon marrëdhëniet juridike-shoqërore.

Prandaj është e nevojshme të forcohet edhe më shumë vetëdija e prokurorëve të shtetit për domosdoshmërinë e rritjes së efikasitetit dhe vendosmërisë në ndjekjen, zbulimin dhe ndëshkimin e këtyre rasteve. Për trajtimin e lëndëve të korrupsionit të nivelit të lartë, kemi nevojë për njerëz profesionistë, të guximshëm, me integritet dhe të trajnuar, që sigurisht ekzistojnë brenda sistemit prokurorial.

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është agjendë shtetërore e Republikës së Kosovës dhe një element shumë i rëndësishëm në rrugën integruese të shtetit tonë në familjen e madhe evropiane.

Në këtë drejtim kemi shënjestruar edhe tetë (8) raste të reja që kanë të bëjnë me korrupsionin e nivelit të lartë, krimin e organizuar dhe krimet e tjera të rënda, duke e dërguar në 69 numrin e rasteve të shenjëstruara.

Gjatë vitit të kaluar janë ngritur aktakuza të ndryshme për vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ku në mesin e të akuzuarve ka edhe ish-ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjyqtarë, policë dhe zyrtarë të tjerë shtetëror, me ç'rast kemi dëshmuar se askush nuk është i paprekshëm për Prokurorin e Shtetit dhe se do të vihen para drejtësisë të gjithë ata persona që kanë rënë ndesh më ligjin, pavarësisht statusit të tyre në shoqëri apo funksionit që ushtrojnë.

Me qëllim të forcimit të sundimit të ligjit dhe avancimit të luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe konfiskimit të pasurive të fituara jashtëligjshëm, me mbështetjen e UNDP-së në Kosovë, si Kryeprokuror i Shtetit, kam nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit me Institutin e Bazelit, i cili do t'i ndihmojë Prokurorisë në gjurmimin dhe identifikimin e aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme të shtetasve kosovarë, asete këto, të cilat gjenden jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, së bashku me Administratën Tatimore të Kosovës, kemi nënshkruar memorandum ndërinstitucional, me anë të të cilit synohet intensifikimi i bashkëpunimit në shkëmbimin e informacioneve dhe evidentimin e rasteve kur ka mospërputhje në mes të hyrave dhe

shpenzimeve të personave fizikë dhe atyre juridikë që veprojnë në Kosovë, të cilët dyshohen që kanë kryer vepër penale dhe kanë krijuar pasuri të pajustifikueshme.

Jemi të vetëdijshëm se vetëm dënimi me burg i kryesve të veprave penale nuk e lëvizë seriozisht luftën kundër korrupsionit, por krahas tyre duhet të nxirren edhe sanksione plotësuese për ndalimin e ushtrimit të detyrës zyrtare, por edhe vendime për konfiskimin e përhershëm të pasurisë së fituar me vepër penale.

Çelësi i suksesit në luftën kundër korrupsionit qëndron në marrjen e fuqisë ekonomike dhe pasurisë së paligjshme të individëve dhe grupeve kriminale· Në këtë drejtim, roli i prokurorëve duhet të bëhet më proaktivë.

Rëndësi të madhe i kemi kushtuar edhe luftimit të krimit të organizuar. Gjatë vitit të kaluar, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur shtatë (7) raste me 34 persona, nga gjithsejtë (8) raste sa i ka pranuar në punë.

Falë një hetimi të gjatë të udhëhequr nga Prokurori i Shtetit dhe një bashkëpunimi të ngushtë me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, si me Policinë dhe Inspektoratin Policor, në shtator të vitit 2020 është zhvilluar një operacion i madh në fshatin Karaçevë të Komunës së Kamenicës, ku me urdhër të prokurorisë u shkatërrua një vatër e madhe e krimit të organizuar, me ç'rast janë arrestuar dhjetëra persona në mesin e tyre edhe zyrtarë policorë, si dhe janë sekuestruar sasi të konsiderueshme të gjërave me vlerë.

Të nderuar,

Jemi të vetëdijshëm se rreziqet bashkëkohore të drejtësisë dhe sigurisë nuk mund të zgjidhen nga një shtet i vetëm, prandaj kemi rritur bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtarë në luftimin e krimeve transnacionale.

Ne tashmë kemi bërë progresin e duhur institucional dhe shtetëror edhe në luftë kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Kjo dëshmohet edhe nga raportet me kredibile ndërkombëtare, ku së fundmi, sipas Indeksit Global të Terrorizmit, Republika e Kosovës është renditur në vendin e 135-të, si një ndër vendet më të sigurta në botë, ku ndikimi i terrorizmit është minimal.

Në këtë drejtim, dëshiroj të falënderoj SHBA-të, për ndihmën e dhënë në forma të ndryshme për institucionin e Prokurorit të Shtetit, si dhe mbështetjen e vazhdueshme për Republikën e Kosovës, në luftë kundër terrorizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Ne do të vazhdojmë të jemi partnerë besnikë të tyre dhe vendeve të tjera perëndimore në luftë kundër terrorizmit dhe krimeve të tjera që cenojnë vlerat demokratike të shoqërive tona.

Vëmendje të posaçme iu kemi kushtuar edhe kërkesave që kanë ardhur nga shtetet e tjera për ndihmë juridike ndërkombëtare. Në këtë fushë janë zgjidhur 342 kërkesa dhe janë ndërmarrë veprime hetimore sipas kërkesave të shteteve të huaja.

Lidhur me trajtimin e krimeve të luftës, dëshiroj të nënvizoj faktin se janë bërë hapa pozitivë në fuqizimin e Departamentit të Krimeve të Luftës, i cili funksionon në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ku krahas strategjisë për trajtimin e krimeve të luftës, është caktuar edhe një prokuror i ri në këtë departament, duke e çuar në katër (4) numrin e prokurorëve që merren ekskluzivisht me këto raste.

Mirëpo, për të pasur sukses më të madh, është thelbësore të kemi mbështetje të gjerë institucionale në ngritjen e resurseve për trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, të përmirësohet legjislacioni që lehtëson ndjekjen, hetimin dhe gjykimin në mungesë, si dhe të rregullohet çështja e ekstradimit të të dyshuarve me shtetet që nuk e njohin Republikën e Kosovës, veçmas me Serbinë, e cila akoma nuk i dorëzon shtetasit e vet, ashtu që kryerësit e këtyre veprave penale po bëhen të paarritshëm për organet e drejtësisë në Kosovë.

Dëshiroj të theksoj faktin se, në dhjetor të vitit 2020, Prokuror i Shtetit ka marrë mbështetje të fuqishme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për trajtimin e krimeve të luftës dhe jam optimist që së shpejti do të tregojmë rezultate në këtë drejtim.

Në anën tjetër, mbrojtja e viktimave të krimit ka qenë prioritet i përkushtimit tonë institucional, ku shërbimet ndaj tyre nuk pushuan për asnjë moment as gjatë ballafaqimit me pandeminë Covid-19.

Në vitin 2020, Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ka ofruar ndihmë për 1687 raste të viktimave të të gjitha kategorive. Prej tyre,

1542 kanë qenë viktima të dhunës në familje, 10 raste të trafikimit të qenieve njerëzore. Po ashtu është vërejtur një shtim i rasteve të dhunimeve dhe ngacmimeve seksuale, ku gjatë kësaj kohe janë shënuar 34 raste të dhunimeve dhe 60 raste të tjera të ngacmimeve seksuale.

Shpresojmë se me plotësimndryshimin e Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, do të mund të krijohet qasje më e lehtë në realizimin e të drejtës për kompensim për të gjitha viktimat, pa pasur nevojë të pritet deri në përfundim të procesit gjyqësor.

Të nderuar,

Në fund të vitit të kaluar kemi zgjedhur Kryeprokurorin e ri të Prokurorisë së Apelit dhe gjashtë (6) kryeprokurorët e prokurorive themelore të Republikës së Kosovës.

Kryeprokurorëve të rinj dua t'ju them se që nga marrja e këtyre detyrave iu presin sfida të vështira. Koha nëpër të cilën po kalojmë e vërteton këtë. Përgjegjësia juaj është të tregoni se jeni të gatshëm t'i drejtoni këto prokurori dhe se vendimet që do t'i merrni do të jenë të drejta, profesionale dhe ekskluzivisht në përputhje me normat kushtetuese dhe dispozitat ligjore.

Dua të besoj se të gjithë jeni të gatshëm ta mbroni nderin e institucionit të Prokurorit të Shtetit dhe pres që ta vërtetoni këtë me veprimet tuaja. Në punën dhe udhëheqjen tuaj do ta keni përkrahjen time dhe të sistemit prokurorial në organizimin dhe funksionimin sa më të mirë të këtyre prokurorive.

Të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se besimi, sinqeriteti dhe komunikimi në mes të prokurorëve, kryeprokurorëve dhe Kryeprokurorit të Shtetit duhet të forcohet, në mënyrë që të ngritët performanca, autoriteti dhe prestigji i institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Gjatë vitit që lamë pas, më qëllim të riorganizimit, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të Prokurorisë Speciale, krahas Departamentit për Krime të Luftës, i cili ishte themeluar në vitin 2015, në këtë prokurori janë themeluar edhe tri departamente të reja: ai për Krim të Organizuar dhe Krime të Tjera në Kompetencë të PSRK-së, Departamenti për Terrorizëm, dhe Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar.

Në këto departamente janë ndarë dhe profilizuar edhe prokurorët përkatës dhe kjo do të ndikojë drejtpërsëdrejti në ngritjen e përformancës së kësaj prokurorie, juridiksioni i së cilës shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës në hetimin dhe ndjekjen e krimeve më të rënda.

Po ashtu, tashmë në Prokurorinë Speciale janë emëruar edhe katër (4) prokurorë të rinj dhe jam i bindur se energjia, guximi, integriteti dhe profesionalizmi i këtyre prokurorëve do të sjellë rezultate të mira veçmas në trajtimin e lëndëve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimeve të tjera që janë në kompetencë të kësaj prokurorie.

Ndërkaq, më qëllim të avancimit të transparencës, Prokurori i Shtetit, me qasje objektive dhe të paanshme, ka qenë i hapur për të komunikuar dhe bashkëpunuar me mediat dhe shoqërinë civile, duke e ruajtur gjithnjë ekuilibrin e duhur në mes të integritetit të hetimeve dhe procedurës penale, në njërën anë, si dhe interesit të publikut për të marrë informacione, në anën tjetër. Ne do të vazhdojmë ta rrisim këtë bashkëpunim brenda standardeve profesionale, sepse mediat dhe shoqërinë civile i konsiderojmë partnerë të fuqishëm në luftën kundër të gjitha fenomeneve kriminale që ndodhin në shoqërinë tonë.

Në mënyrë të qartë, gjatë vitit 2020, kemi demonstruar vendosmërinë institucionale për të përmirësuar sistemin e drejtësisë në vendin tonë.

Institucioni i Prokurorit të Shtetit ka kontribuar në mënyrë aktive edhe në grupet punuese të Rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit dhe hartimin e Konceptdokumentit lidhur me modalitetet e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Më këtë rast dëshiroj të them se cilatdo qofshin motivet që e shtyjnë Republikën e Kosovës që të marrë iniciativa për reforma në drejtësi, udhëheqës dhe rregullator i këtyre reformave duhet të jenë vetë njerëzit e sistemit të drejtësisë në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me Ambasadën Amerikane, atë të Britanisë së Madhe, Zyrën e BE-së, ambasadat e tjera të vendeve perëndimore dhe me shoqërinë civile.

Kjo reformë apo vetting në sistemin gjyqësor duhet të përqendrohet në fuqizimin e komisioneve, të cilat funksionojnë brenda Këshillit Prokurorial dhe atij Gjyqësor, duke e ngritur kështu llogaridhënien,

transparencën dhe profesionalizmin e bartëseve të funksioneve prokuroriale dhe gjyqësore.

Konsolidimi i pushtetit gjyqësor nuk varet vetëm nga reformat ligjore, por edhe nga vullneti i mirë për të qenë të drejtë, që nënkupton qëndrueshmëri në zbatimin e ligjit dhe integritet të lartë moral e profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këto veçori duhet të jenë standarde të një sistemi vlerash, të cilin po synojmë ta forcojmë.

Në fund, dëshiroj të them se brenda sistemit të drejtësisë ende ekzistojnë vështirësi dhe sfida, të cilat nuk duhet t'i shohim si pengesa. Përkundrazi, zgjidhjen e tyre jemi duke e parë si një objektiv që duhet realizuar sa më shpejtë në të ardhmen.

Besoj fuqishëm se në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë do ta forcojmë sundimin e ligjit dhe institucionet e pavarura të drejtësisë, të cilat promovojnë paanshmëri, transparencë dhe llogaridhënie, që janë atribute thelbësore për përparimin e shtetit tonë.

Nga ju, kolegë të nderuar, pres që këtë vit të tregoni përkushtim më të madh, profesionalizëm, integritet dhe përgjegjësi në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që ta forcojmë besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Ju uroj punë të mbarë dhe suksese në vitin që sapo kemi filluar!

Aleksandër Lumezi

Kryeprokurori i Shtetit

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Fjalimi i U.D. Presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve

Të nderuar përfaqësues të institucioneve vendore e përfaqësues diplomatik të shteteve mike,

Te nderuar te pranishem

Kam kënaqësinë që sot para jush të përcjellë mesazhin tim lidhur me një ndër hallkat kryesore të zinxhirit institucional në vend, pa të cilin nuk mund të kemi shtet ligjor dhe sundim të rendit dhe ligjit.

Shteti ligjor dhe i së drejtës është parakusht për funksionimin e shteteve demokratike dhe shoqërive të hapura. Në Republikën e Kosovës, për 20 vite me rradhë, është investuar në shumë drejtime për të ndërtuar institucione të besueshme të drejtësisë, me kapital njerëzor të kualifikuar dhe resurse të mjaftueshme për të kryer me sukses detyrat e punës. Në këtë drejtim, shtetet që i qëndruan afër në cdo kohë Republikës së Kosovës, kanë ofruar ndihmë të jashtëzakonshme, për cka dua edhe sot t'i falënderoj përzemërsisht, në emër të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Përkundër angazhimit dhe rezultateve të mira, raportet ndërkombëtare

vazhdojnë të ofrojnë rekomandimet e veta për të përmirësuar performancën dhe kësisoji edhe rezultatet e punës së institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu edhe Prokurorinë.

Puna e një prokurori është punë me përgjegjësi të jashtëzakonshme. Suksesi i Prokurorisë është sukses i gjithë shtetit tonë, prandaj të gjithë ne, qoftë përfaqësuesit e institucioneve por edhe të gjithë qytetarët e vendit tonë, duhet të ofrojmë kontributin tonë maksimal për të siguruar institucione të pavarura, kredibile e profesionale të cilat luftojnë krimin e korrupsionin, ruajnë integritetin institucional e mbi të gjitha e bëjnë Republikën tonë një vend të dëshirueshëm për të rritur fëmijët tanë.

Dihet se është parim fundamental për një shtet demokratik që prokurorët dhe sistemi gjyqësor dhe prokurorial të jenë të paanshëm, të pavarur dhe të drejtë në ushtrimin e funksioneve prokuroriale. Gjykatësit dhe prokurorët gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, përveç faktit që duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të njëjtit edhe në publik të kenë përceptimin dhe besimin e qytetarëve dhe publikut se të njëjtit janë të pavarur, të paanshëm dhe të drejtë në ushtrimin e funksioneve të tyre zyrtare.

Prandaj, integriteti i prokurorëve është bazament i punës së tyre, bashkë me profesionalizmin dhe etikën e punës. Prandaj, dua t'ju percjelle mesazhe inkurajimi për punë të mëtutjeshme, duke u treguar të pakompromisë ndaj shkelësve të ligjit.

Integriteti, profesionalizmi e vetëmohimi i prokurorëve tanë është garanca që e kërkojmë të gjithë në Republikën e Kosovës. Duke u nisur nga parimi se të gjithë jemi të barabartë para ligjit, pikërisht edhe puna jonë në institucione duhet të jetë e bazuar në këtë maksimë, për të na shërbyer si udhërrëfyes në punën tonë të përditshme. Zbatimi i këtij parimi është sidomos i domosdoshëm në punën tuaj, prokurorë të nderuar. Intoleranca juaj për shkelësit e ligjit, kushdo e kudo qofshin ata, është ajo cfarë të gjithë qytetarët tanë presin nga ana juaj. Prandaj, edhe njëherë dua t'u ofroj tërë mbështetjen time në këtë drejtim.

Duke jetuar në një kohë dinamike, ku në cdo moment ndodhin zhvillime të reja, është me rëndësi që edhe puna e Prokurorisë të jetë e shpejtë, efikase e veprimet të ndërmirren në kohë. Kësisoji, duke

vepruar menjëherë e pa vonesa, ne mbrojmë jetën e qytetarëve tanë, garantojmë jetë familjare pa dhunë, mundësojmë zhvillim normal të punës në institucione e përfundimisht ofrojmë garancinë e të jetuarit në një vend ku sundon ligji dhe askush tjetër.

Ngritja e mëtutjeshme e kapaciteteve profesionale e logjistike, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, janë disa nga aspektet tjera me rëndësi jetike për zhvillim edhe të mëtutjeshëm të Prokurorisë sonë. Ndarja e përvojave mes institucioneve, sidomos atyre të drejtësisë, mundëson rritje të efikasitetit dhe koordinim më të mirë në luftë kundër krimit. Në anën tjetër, investimi në ngritje të kapaciteteve profesionale dhe logjistike e administrative, padyshim se do të rris nivelin e profesionaizmit, angazhimit dhe rezultateve të përgjithshme të këtij institucioni.

Si Presidente në detyrë, dhe përgjatë gjithë karrierës sime, kam kërkuar vetëm shtet të së drejtës, rend dhe ligj. Tani, i gjithë kapaciteti im institucional e profesional, është në dispozicion të kësaj kauze. Do të jem aleati juaj kryesor, për aq sa kam kompetenca kushtetuese, për t'u ndihmuar në këtë drejtim.

Ju faleminderit

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

JANAR 2021

Fjalimi i Ministrit të Drejtësisë në detyrë, Selim Selimi, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve

Të nderuar prokuror unë jam i njoftuar me punën tuaj, i di sfidat me të cilat ju ballafaqoheni, dhe e di që ju jeni shtylla kryesore e mbrojtjes së Kosovës dhe e mbrojtjes së Sundimit të Ligjit.

Me ndryshimet e fundit në Procedurën Penale ju do të keni më shumë mundësi të i ndiqni të korruptuarit dhe do të keni më shumë mundësi që t'i ndiqni Krimet e Luftës.

Ne kemi bërë ndryshim edhe në sistemin e Vettingut, të cilin e kemi bërë bashkë me juve. Ky Vetting do të jetë për ta mbrojtur ndershmërinë e prokurorit dhe për ta mbrojtur prokurorinë.

Ne e kemi bërë edhe Rishikimin Funksional, një reformë e thellë në Sistemin e Drejtësisë, që prokurorisë do t'i jap forcë, pavarësi dhe punë.

Atë që kemi bërë më herët, rritjen e pagave për prokurorët ne do të vazhdojmë të punojmë që të keni kushte më të dinjitetshme.

Kemi mbajtur me ngulm të gravuar në të gjitha veprimet tona, Politika duart larg nga drejtësia.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Fjalimi i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve

I nderuar Kryeprokuror i Shtetit,

E nderuara U.D. Presidente e Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë anëtarë të Këshillit dhe të gjithë ju që jeni pjesë e sistemit prokurorial,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të ambasadave të ndryshme, që veproni në Kosovë,

Të nderuar mysafirë, përfaqësues të institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë,

Të nderuara media dhe shoqëri civile,

Është kënaqësi e veçantë për mua që si Kryesues i ri i Këshillit Prokurorial të Kosovës t'ju drejtohem me rastin e Konferencës Vjetore të Prokurorëve.

Nuk ka shumë kohë që jam zgjedhur në këtë pozitë, por ka shumë

kohë që jam pjesë e udhëheqjes në sistemin prokurorial. Nga kjo perspektivë, për mua, është një fillim i ri, por edhe për ju do të jetë një fillim i ri, sepse pas shumë të arriturave që kishim së bashku në të kaluarën, do të ndeshemi çdo ditë me sfida e punë të shumta, të cilat presin vendimin tonë.

Sot ne duhet të ndihemi krenarë për të arriturat e përbashkëta, por dua t'ju them se do të vazhdojmë të punojmë së bashku në avancimin e sistemit prokurorial përmes aplikimit të standardeve më të larta në vendimmarrje. Ne së bashku do të vazhdojmë të ngrisim nivelin e llogaridhënies, efikasitetit dhe cilësisë së punës në zgjidhjen e rasteve. Ky synim do të bëjë të mundur të kemi një sistem prokurorial me integritet, transparent dhe që gëzon besimin e publikut.

Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit vazhdimisht kishin objektiva që të krijojnë kushte më të mira për punë, numër të mjaftueshëm të prokurorëve dhe stafit administrativ, si dhe infrastrukturë dhe pajisje moderne, andaj, sot, dua ta siguroj çdo të punësuar në sistemin prokurorial, se të gjithë së bashku do ta arrijmë këtë. Do të punojmë së bashku me të gjitha njësitë e Këshillit, me Sekretariatin, me Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive dhe të gjithë partnerët tonë ndërkombëtarë dhe vendorë që të arrijmë objektivat e planifikuara.

Ne do të avancojmë sistemin e planifikimit duke punuar së bashku; do të rrisim buxhetin përmes një bashkëpunimi më të mirë me Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe do ta shpenzojmë buxhetin efektivisht dhe për nevoja që i ka sistemi prokurorial.

Ne do të rekrutojmë numrin e planifikuar të prokurorëve dhe personelit administrativ dhe do të punojmë së bashku me Akademinë e Drejtësisë dhe partnerët tanë ndërkombëtarë që të trajnojmë e specializojmë prokurorët, bazuar në nevojat e tyre për ngritje profesionale dhe etike. Me këtë rast, dua të falënderoj të gjithë ata që mbështetën këto zhvillime ndër vite.

Para disa ditësh, Këshilli Prokurorial është plotësuar me anëtarë të rinj dhe aktualisht jemi në proces të konsolidimit të komisioneve të përhershme dhe përcaktimit të planeve konkrete të punës. Ju siguroj se pjesë e këtyre planeve do të jenë forcimi i vazhdueshëm i integritetit të sistemit prokurorial përmes një sistemi të mirëfilltë të rekrutimit të prokurorëve bazuar në mëritë, vlerësimi i performancës

së prokurorëve, vendimmarrja proaktive, e cila siguron llogaridhënie dhe punë transparente, të mbështetur në ligj dhe në standarde ndërkombëtare. Pa dyshim se në fokus do të jetë edhe trajtimi i rasteve disiplinore dhe ju siguroj që çfarëdo sjellje jokorrekte dhe e qortueshme do të trajtohet seriozisht, shkelësit do të ndëshkohen pa kursyer dhe nuk do të lejojmë të zbehet besimi i publikut, por do të ruhet imazhi i sistemit prokurorial.

Në mes të prioriteteve të Këshillit do të jetë edhe avancimi i statusit të prokurorëve dhe personelit administrativ, ndërsa do të promovohet më tutje dhe aplikohet pa kushte sistemi elektronik i menaxhimit të rasteve, siç është digjitalizimi i proceseve të punës kudo në sistemin prokurorial.

Për të gjithë ata që përcjellim rrjedhat në sistemin prokurorial, dua të theksoj se çmojmë lart dhe llogarisim në mbështetjen e partnerëve tonë nga Ambasada Amerikane, Zyra e Bashkimit Evropian, Ambasada e Mbretërisë Norvegjeze, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, Ambasada e Zvicrës, Ambasada e Mbretërisë së Holandës, Ambasada e Gjermanisë, Ambasada e Italisë, UNDP-ja, GIZ-i, IRZ-ja, OSBE-ja, Këshilli i Evropës etj.

Miq të dashur, të gjithë e dimë se sistemi i drejtësisë në përgjithësi dhe ai prokurorial në veçanti kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme reformash, të cilat planifikohen edhe në të ardhmen. Në një ditë si kjo, ne duhet t'i kujtojmë ato zhvillime reformuese, por edhe duhet të punojmë më shumë dhe të përmirësojmë pozitën tonë, por gjithashtu duhet që të punojmë më tepër dhe për qytetarët e vendit tonë, pa dallim dhe t'u ofrojmë atyre drejtësi.

Të nderuar kolegë prokurorë, që të kemi besimin e publikut në punën tonë, ne duhet të punojmë pa u ndaluar dhe të krijojmë një ambient ku ka qasje më të lehtë në drejtësi për të gjithë. Andaj, dua të përmend shkurtimisht se disa nga prioritetet e Këshillit për këtë vit, të cilat do të jenë si vijon:

- Avancimi i sistemit të administrimit të të gjitha niveleve, përfshirë fuqizimin e kornizës ligjore dhe strukturës organizative përkatëse;
- Forcimi i integritetit të sistemit prokurorial (prokurorëve dhe stafit);
- Ngritja e nivelit të llogaridhënies dhe kontrolli permanent i

punës;
- Avancimi i sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve;
- Ngritja e nivelit të transparencës;
- Avancimi i kritereve për rekrutim mbi bazë të meritave;
- Zhvillimi i mëtejmë i sistemit të ngritjes në karrierë;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i planifikimit, buxhetit dhe kushteve për punë;
- Ngritja profesionale e prokurorëve dhe stafit administrativ dhe
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me partner vendorë dhe ndërkombëtarë.

Përfundimisht, iu thërras të mbështetni sistemin prokurorial që të funksionojë si i pavarur, profesional, transparent, efikas, efektiv dhe llogaridhënës.

Duke vlerësuar lart rëndësinë e kësaj konference, i falënderoj të gjitha ata që punuan rreth organizim të saj dhe ju dëshiroj suksese.

Ju faleminderit!

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Fjalimi i Ambasadorit të SHBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve

22 janar 2021 -

Mirëmëngjesi. Fillimisht, më lejoni të falënderoj kryeprokurorin e shtetit Lumezi për ftesën për të folur sot gjatë konferencës vjetore të prokurorëve. Fakti që sërish po ju drejtohem në mënyrë virtuale vetëm na i përkujton sërish testet e ndryshme me të cilat po përballemi gjatë kësaj kohe të padëgjuar. Për fat të keq, nuk po flas vetëm për ndikimin e pandemisë.

Sot, nuk po kërcënohet vetëm shëndeti ynë, por edhe vetë demokracia. Si të gjithë ju, edhe unë u trondita nga ngjarjet e kohëve të fundit në Uashington. Dhuna politike e 6 janarit ishte përkujtuese e zymtë e brishtësisë së demokracisë, rëndësisë së sundimit të ligjit dhe rrezikut të gënjeshtrave dhe keqinformatave.

Por, përkundër dhunës dhe përpjekjeve tjera për t'i përmbytur zgjedhjet tona, institucionet tona rezistuan dhe bartja e pushtetit po vazhdon në përputhje me Kushtetutën tonë. Jam i bindur se Amerika do të dalë më e fortë se kurrë nga kjo periudhë kritike, por përpara nesh ende kemi edhe shumë punë dhe shumë dhimbje.

Sadoqoftë shqetësuese ishin këto ngjarje, kjo nuk është hera e parë që vlerat dhe institucionet tona demokratike janë testuar. Më duket e udhës t'i kthehem historisë për udhëzime. Një vegëz e përbashkët gjatë historisë, që është e vërtetë në vendin tim dhe tuajin, është se kohët e rrezikshme kërkojnë vepra të jashtëzakonshme nga individët e zakonshëm.

Individët si Anton Çetta, këtu në Kosovë. Si antropolog, z. Çetta punoi për të ruajtur trashëgiminë e pasur kulturore dhe historinë e Kosovës. Megjithatë, ai e kuptonte se disa tradita nuk përputheshin me të ardhmen demokratike të Kosovës. Për këtë arsye, e nën kërcënimin e madh personal dhe ndaj familjes së tij, z. Çetta punoi palodhshëm për të arritur paqe ndërmjet familjeve dhe për t'i dhënë fund brezave të tërë të gjakmarrjes. Z. Çetta e dinte se që institucionet demokratike të Kosovës të kishin sukses, publiku nuk mund dhe nuk duhej të luante rolin e gjykatësit, porotës dhe ekzekutuesit. Puna e tij forcoi respektin e Kosovës ndaj sundimit të ligjit dhe ju fuqizoi juve për tu bërë arbitra të drejtësisë.

Në Shtetet e Bashkuarra të Amerikës, frymëzohem po aq nga jeta e gjyqtarit Elbert Tuttle (Elbert Tatël), gjyqtar i apelit në Gjorgji në kulmin e lëvizjes për të drejtat civile në Amerikë gjatë viteve 1960. Gjatë gjithë jetës së tij, gjyqtari Tuttle luftoi palodhshëm për liritë civile të afrikano-amerikanëve. Atij shpesh i jepen meritat si njëri ndër arkitektët e heqjes së ndarjes raciale në jug. Përkundër sulmeve të panumërta personale dhe kërcënimeve fizike, Tuttle vazhdoi me ngulm duke avancuar të drejtat civile për komunitetet e lëna anash. Edhe pse ende mbetet shumë punë për të avancuar barazinë, përmes përkushtimit të një njeriu ndaj drejtësisë, premtimi i Gjykatës së Lartë për vendimet kundër ndarjes raciale u bë realitet.

Këto janë vetëm dy nga shumë shembuj historikë kur individët janë përballur me rrezikun për të mbrojtur vlerat që ata i vlerësojnë lart. Madje edhe përderisa po ndodhte dhuna e fundit në Kapitol, heronj vetëmohues demonstruan guxim të madh me veprime të mëdha e të vogla. Shumë prej jush keni dëgjuar rrëfimin për personelin e Kongresit që patën mendjen dhe guximin për t'i ruajtur votat e Kolegjit Elektoral dhe për t'i siguruar ato. Po e them sërish, këta janë qytetarë të rëndomtë, të cilët, kur u përballën me test, e bënë të duhurën – duke ndihmuar për të ruajtur dhe mbrojtur institucionet dhe vlerat tona demokratike.

Prandaj, prokurorë, mbrojtës të viktimave dhe staf ndihmës – mbani në mend që publiku ju beson që të jeni prijës të sundimit të ligjit. Mos iu frikësoni llogaridhënies – përqafojeni atë. Kërkoni nga vetja, kolegët dhe prijësit tuaj që t'i përmbaheni standardit më të lartë ligjor dhe etik. Mbroni me forcë të drejtat e viktimat dhe siguroni dinjitet njerëzor për të akuzuarit. Kërkoni drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh pozita e tyre në shoqëri.

Dhe ju nxis t'i mbani këto standarde dhe të shërbeni si shembull në shoqëri edhe në jetën tuaj personale. Kjo përfshin edhe luftën kundër pandemisë – bartni maskën, bindjuni rregullave të orarit kufizues dhe zvogëloni kontaktin shoqëror për të shmangur rrezikimin e panevojshëm të jetës. Nëse prokurorët nuk i marrin këto masa seriozisht, atëherë kush?

Jam i bindur se ju do të tregoni forcën dhe zgjuarsinë e duhur për të rezistuar dhe mbizotëruar në mbrojtje të lirisë, demokracisë dhe ligjit. Sepse me fjalët e Të Përndershmit Martin Luther Kingut të Riut: „Një njeri përfundimisht nuk matet me qëndrimin që e merr kur është rehat e mirë, por me qëndrimin që e merr kur përballet me sfida dhe polemika".

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

JANAR 2021

Fjalimi i Shefit të Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve

Shkëlqesia juaj Ushtruese e Detyrës së Presidentes, i nderuar z. Kryeprokuror i Shtetit Lumezi, i nderuar z. Kryetar i KPK-së Maloku, i nderuar Ministër i Drejtësisë Selimi, Ambasadorë Kosnett, Kolly dhe Lobbezoo, zonja dhe zotërinj.

Ju jam shumë falënderues që më keni ftuar të flas në emër të BE-së. Edhe pse jemi duke kaluar këto kohë të vështira të Covid-it, është kënaqësi që më jepet mundësia të jem pjesë e konferencës suaj, në të cilën do të diskutohen një numër çështjesh me rëndësi.

Prokuroria është një nga shtyllat kryesore të Sundimit të Ligjit. Krijimi dhe ruajtja e një prokurorie efikase, të pavarur dhe llogaridhënëse është proces i vështirë, kompleks dhe i vazhdueshëm.

E dimë mirë se në punën tuaj të përditshme si anëtarë të shërbimit të prokurorisë, ju përballeni me sfida të panumërta.

Në përditshmërinë tuaj ju përballeni me

Kufizimet prej pandemisë Covid19,

Presionin prej lëndëve të prapambetura,

Burimet e kufizuara njerëzore dhe financiare,

Zbatimin e Sistemit për Menaxhim Informativ të Lëndëve dhe ndryshimin e procedurave të punës,

Mungesën e stafit mbështetës

Dhe rastet e ndikimeve të padrejta ndaj jush dhe lëndëve tuaja.

Përkundër këtyre sfidave, ne vazhdojmë të besojmë në mundësinë e arritjes së rezultateve më të mira, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në këtë drejtim, lëndët do të duhej të trajtoheshin në mënyrë më efikase dhe profesionale. Pritjet tona janë të mëdha kur flitet për specializimin në kuadër të Prokurorisë së Shtetit, veçanërisht kur flitet për PSRK-në (Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës).

Është gjithashtu e rëndësishme të nënvizohet se puna e prokurorit fillon me udhëheqjen e hetimit por nuk përfundon me ngritjen e aktakuzës. Fitorja në luftën kundër krimit vjen vetëm kur jepen dënime të formës së prerë në gjykatë.

Veç kësaj, konfiskimi i pasurive është thelbësor për luftimin e krimit ekonomik. Është i lartë numri i konfiskimeve paraprake të pasurive të kryera gjatë procedurave penale. Por ende mbetet i ulët numri i konfiskimeve përfundimtare.

Në mënyrë që të lehtësohet më tej rikuperimi i të ardhurave të krimit dhe që pasuritë të konfiskohen në mënyrë efektive, BE-ja dhe të gjithë partnerët ndërkombëtarë e inkurajojnë Kosovën që ta themelojë sa më shpejt fondin për këtë qëllim specifik. Do të duhej të kishte përparim në zbatimin e legjislacionit në lidhje me konfiskimin, veçanërisht të Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskim.

Ne shpresojmë edhe që gjatë vitit 2021 më në fund të miratohet dhe të hyjë në fuqi drafti i Kodit të ri të Procedurës Penale. Legjislacioni i ri sjell disa ndryshime në procedurat penale, të cilat nëse zbatohen siç duhet shpresohet të kenë ndikim pozitiv në efektivitetin e ndjekjes penale të lëndëve.

Për forcimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit dhe rritjen e

llogaridhënies, efikasitetit dhe integritetit të institucioneve, ne i mirëpresim përpjekjet për përgatitjen e Strategjisë për Sundim të Ligjit, të bazuar në Rishikimin Funksional. Kjo është një përpjekje e përbashkët e ministrive, gjyqësorit dhe prokurorisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, si dhe partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile.

Në muajin tetor, për forcimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial Bashkimi Evropian lansoi Programin për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë. Ky program, do të zgjasë për 3 vitet e ardhshme.

Prokuroria është një nga institucionet kyçe që mund të përfitojë nga ky projekt që zbatohet në bashkëpunim me shërbimet relevante në Gjermani, Holandë dhe Kroaci. Besoj se kjo është një mundësi e shkëlqyer që ju të punoni me homologët tuaj evropianë për forcimin e kapaciteteve tuaja.

Për fundi, më lejoni ta përmend projektin e financuar nga BE-ja për Krimin Ekonomik, i njohur edhe si projekti PECK. Përmes mentorimeve të drejtpërdrejta dhe trajnimeve në vendin e punës nga ekspertë të nivelit të lartë nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, ky projekt mund t'u ndihmojë prokurorëve që punojnë për ndjekjen penale të krimeve më komplekse ekonomike. Shpresoj që prokuroria ta shfrytëzojë në mënyrë aktive të gjithë këtë mbështetje.

Më lejoni ta përfundoj duke thënë se Bashkimi Evropian do të vazhdojë t'ju mbështesë në veprimet tuaja për sigurimin e një shërbimi prokurorial të pavarur, efikas, transparent dhe llogaridhënës. Ju uroj sukses në Konferencën tuaj të sotshme.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Fjalimi i Ambasadorit të Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve

Përshëndetje për Shkëlqesitë dhe kolegët

Shkëlqesia juaj kryeprokuror I shtetit z. Aleksandër Lumezi

Shkëlqesia juaj ushtruese e detyrës se presidentit te Kosovës znj. Vjosa Osmani

Shkëlqesia juaj ambasadori I Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë z. Philip Kosnett

Shkëlqesia juaj ambasador, Shef i zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë / përfaqësues special I BE-së z. Tomas SZUNYOG

Shkëlqesia juaj , ambasador I mbretërisë së Holandës në Kosovë , znj. Carin Lobbezoo,

Shkëlqesia juaj ministër në detyrë I drejtësisë Selim Selimi.

Është kënaqësi për mua që të flas në këtë Konferencë Vjetore të Prokurorëve

Zvicra mbështet Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit që nga viti 2016

Megjithatë ne kemi filluar të mbështesim përpjekjet anti-korrupsion përmes UNDP-së udhëhequr nga projekti SAEK në 2012.

Mbështetja jonë ka qenë gjithmonë e drejtuar nga tri pika kyçe :

Së pari, mbrojtja dhe përparimi i sundimit të ligjit në Kosovë kërkon institucione të forta, profesionale dhe të pavarura.

Së dyti, korrupsioni pengon zhvillimin, ndikon negativisht në tregun e punës dhe anon pasurinë në favor të disave.

Së treti, të gjithë në Kosovë duhet të zbatojnë ligjin, askush nuk është mbi ligjin.

Zvicra është përpjekur në mënyre sistematike të fuqizoj qytetarët dhe të përmirësoj qasjen ne informata. Që nga viti i fundit, ne gjithashtu kemi filluar të fokusohemi në konfiskimin dhe kthimin e pasurisë së vjedhur, dhe së fundi kthimin e kësaj pasurie atyre që u takon-qytetarëve te Kosovës.

Zvicra beson se nënshkrimi I Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Z.Lumezi dhe Institutit të Bazelit per Qeverisje do të ndihmoj në përmirësimin e kapaciteteve hetuese të Kosovës.

Zvicra gjithashtu ka kënaqësinë të mbështes themelimin e platformës së re elektronike që do të lejoj identifikimin automatik te mospërputhjes në mes të ardhurave dhe pasurisë së dikujt. Kjo platformë do të përdoret për të mbështetur hetimet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, shpëlarjen ë parasë dhe konfiskimin e pasurisë se fituar në mënyrë të jashtëligjshme.

Do të doja të lavdëroj z.Lumezi për këtë iniciativë dhe për udhëheqjen e tij në këtë përpjekje.

Zvicra mbetet e përkushtuar të mbështes ndjekjen penale të akteve kriminale në Kosovë dhe presim me padurim të forcojmë bashkëpunimin.

Faleminderit për vëmendjen.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT

JANAR 2021

Fjalimi i Ambasadores së Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Carin Lobbezoo, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve

Zonja Presidente

Ministër i Drejtësisë

Kryeprokuror i shtetit

Kryesues i KPK-së

Të nderuar prokurorë

Zonja dhe zotërinj,

Së pari, unë do të doja të falënderoja nikoqirët e sotëm Kryeprokurorin e Shtetit dhe Kryetarin e KPK-së që më ftuan të flas në Konferencën tuaj Vjetore. Kam nderin dhe kënaqësinë.

Shpesh më pyesin pse Holanda i kushton rëndësi kaq të madhe Sundimit të Ligjit. Për ne, Sundimi i Ligjit është 'një koncept fitues'. Është një parakusht për demokracinë që funksionon mirë; është thelbësore për rritjen ekonomike, për stabilitetin, llogaridhënien dhe

për të siguruar që të gjithë jemi njësoj para ligjit.

Sundimi i ligjit është themeli dhe nëse themeli është i fortë, ashtu do të jetë edhe pjesa tjetër.

Sigurisht që ndërtimi i këtij themeli nuk është një detyrë e lehtë. Duhet kohë, sjell sfida, kërkon vendime të vështira dhe është thjesht punë e vështirë.

Gjatë gjithë viteve përmes programeve dhe ekspertëve tanë, Holanda ka qenë partner i Kosovës në forcimin e Sundimit të Ligjit.

Mbështetja jonë për sistemin e prokurorisë, për ta bërë atë të pavarur, llogaridhënës, efektiv dhe efikas ka qenë dhe është akoma, element kyç në angazhimin tonë për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Dhe nëse bëjmë një hap prapa, ne shohim se është bërë shumë përparim dhe është arritur shumë. Kjo është diçka për tu krenuar dhe për të cilën të gjithë keni kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rrethana jo gjithmonë të lehta.

Por mbetet ende punë dhe përmirësime për t'u bërë. Unë i kuptoj plotësisht sfidat që vijnë me forcimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë.

Shumicën e kohës nuk ka rregullime të shpejta ose zgjidhje të lehta.

Por unë jam i bindur që me angazhimin dhe përkushtimin tuaj, është e mundur të krijoni një sistem efektiv dhe efikas të prokurorisë në të cilin çështjet e vështira si krimi i organizuar dhe korrupsioni i profilit të lartë mund të ndiqen me sukses.

Sidoqoftë, nuk mund ta theksoj mjaft rëndësinë e punës suaj si prokurorë. Në mendjen time ju mund të bëheni 'heronjtë modernë të vendit tuaj'. Por si ta bëni këtë?

Epo, me një farë frymëzimi nga linja ime e punës - diplomacia - dhe një ndihmë të vogël të këshilltarit tim ligjor, unë kam 3 sugjerime rreth të cilave ju mund të jeni të gatshëm të reflektoni.

Para së gjithash. Tregoni se çfarë po punoni. Duke komunikuar në media për hetime të suksesshme, aktakuza dhe ndjekje penale, ju do të krijoni besim në sistemin gjyqësor dhe në të njëjtën kohë bëni të qartë se krimi nuk jep rezultat.

Së dyti. Të merrni rolin kryesor. Është e qartë që prokuroria punon ngushtë me policinë, por duhet të jetë prokurori ai që udhëheq procesin, përcakton strategjinë për hetimin dhe vendos për rrugën përpara.

Së treti. Jini të përgatitur. Në raste të vështira punoni së bashku në ekipe. Diskutimi i rasteve me kolegët ndihmon në përgatitjen më të mirë gjatë prezantimit të rasteve. Puna në ekip gjithashtu siguron hetime me cilësi të lartë dhe ndihmon në shmangien e boshllëqeve ligjore ose afateve që mund t'ju mposhtin gjatë procesit. Dhe gjithmonë përfshini sekuestrimin dhe konfiskimin. Kjo është mënyra e vetme për të siguruar ndëshkimin e duhur të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë.

Shpresoj që ju të merrni frymëzim nga kjo dhe mbase ta diskutoni më tej gjatë Konferencës suaj.

Në ndërkohë, më lejoni t'ju sigurojë se mund të llogarisni në mbështetjen e Holandës në përpjekjet tuaja për të përmirësuar Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Unë sinqerisht shpresoj që në konferencën e vitit të ardhshëm kur të takoheni përsëri do të jeni në gjendje të kushtoni një sasi të konsiderueshme të kohës tuaj për të diskutuar sukseset tuaja të vitit 2021 ndërsa vetëm një numër i kufizuar e sfidave për sistemin e drejtësisë do të mbetet për vitin 2022.

Më lejoni ta mbyll fjalimin duke ju falënderuar për vëmendjen dhe duke ju dëshiruar shumë forcë, mençuri dhe sukses në punën tuaj.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Mbahet Konferenca Vjetore e Prokurorëve të Shtetit

Prishtinë, 22 janar 2021 – Nën patronatin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, është mbajtur Konferenca Vjetore e Prokurorëve, e cila këtë vit për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, është organizuar në formë virtuale nëpërmjet platformës "Zoom".

Konferenca është hapur me fjalimin e Kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi, i cili ka folur për punën, sfidat dhe të arriturat e institucionit të Prokurorit të Shtetit gjatë vitit 2020.

Kryeprokurori Lumezi ka theksuar se përkundër numrit të madh të sfidave dhe vështirësive nëpër të cilat ka kaluar Prokurori i Shtetit, është thelbësor fakti që kemi treguar se jemi të gatshëm dhe të aftë të veprojmë në mënyrë adekuate, duke iu përgjigjur me sukses nevojave të kohës, ku edhe përkundër rrethanave të shkaktuara nga pandemia Covid-19, puna e Prokurorit të Shtetit nuk u ndalua për asnjë moment, duke i kryer kështu me përgjegjshmëri detyrat institucionale të përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

"Për ta dëshmuar këtë, theksoj faktin se gjatë vitit 2020, Prokurori i

Shtetit ka pranuar në punë 43 mijë e 446 kallëzime - lëndë penale, ndërsa ka arritur t'i zgjidhë 49 mijë e 381 lëndë penale. Respektivisht, janë zgjidhur edhe 5 mijë e 935 kallëzime – lëndë penale të bartura nga vitet paraprake", ka thënë Kryeprokurori i Shtetit.

Po ashtu, Kryeprokurori Lumezi, ka deklaruar se gjatë vitit të kaluar janë ngritur aktakuza të ndryshme për vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, ku në mesin e të akuzuarve ka edhe ish-ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjyqtarë, policë dhe zyrtarë të tjerë shtetëror, me ç'rast është dëshmuar se askush nuk është i paprekshëm për Prokurorin e Shtetit dhe se do të vihen para drejtësisë të gjithë ata persona që kanë rënë ndesh më ligjin, pavarësisht statusit të tyre në shoqëri apo funksionit që ushtrojnë.

Kryeprokurori i Shtetit, ndër të tjera ka folur edhe për lidhjen e dy memorandumeve të bashkëpunimit gjatë vitit që lamë pas, përkatësisht memorandumit me Institutin e Baselit, i cili ka për qëllim forcimin e sundimit të ligjit dhe avancimit të luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe konfiskimit të pasurive të fituara jashtëligjshëm, si dhe për memorandumin me Administratën Tatimore, në funksion të intensifikimit të bashkëpunimit në shkëmbimin e informacioneve dhe evidentimin e rasteve kur ka mospërputhje në mes të hyrave dhe shpenzimeve të personave fizikë dhe atyre juridikë që veprojnë në Kosovë, të cilët dyshohen që kanë kryer vepër penale dhe kanë krijuar pasuri të pajustifikueshme.

Gjithashtu, një fjalë rasti e ka mbajtur edhe Kryesuesi i ri i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku, i cili ka folur për prioritet e tij si Kryesues i KPK-së, në prioritetet e Këshillit në avancimin e sistemit të administrimit të të gjitha niveleve, përfshirë fuqizimin e kornizës ligjore dhe strukturës organizative përkatëse, forcimi i integritetit të sistemit prokurorial (prokurorëve dhe stafit), ngritjen e nivelit të llogaridhënies dhe kontrolli permanent i punës, avancimin e sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve, ngritjen e nivelit të transparencës, avancimin e kritereve për rekrutim mbi bazë të meritave, zhvillimin e mëtejmë të sistemit të ngritjes në karrierë, përmirësimin e vazhdueshëm të planifikimit, buxhetit dhe kushteve për punë, ngritjen profesionale të prokurorëve dhe stafit administrativ si dhe bashkëpunimin dhe koordinimi me partner vendor dhe ndërkombëtar.

Në anën tjetër, u.d. Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa

Osmani, me rastin e mbajtjes së Konferencës Vjetore të Prokurorëve, ka thënë se puna e një prokurori është punë me përgjegjësi të jashtëzakonshme. "Suksesi i Prokurorisë është sukses i gjithë shtetit tonë, prandaj të gjithë ne, qoftë përfaqësuesit e institucioneve por edhe të gjithë qytetarët e vendit tonë, duhet të ofrojmë kontributin tonë maksimal për të siguruar institucione të pavarura, kredibile e profesionale të cilat luftojnë krimin e korrupsionin, ruajnë integritetin institucional e mbi të gjitha e bëjnë Republikën tonë një vend të dëshirueshëm për të rritur fëmijët tanë", ka deklaruar në mes të tjerash u.d Presidentja Osmani.

Ndërkaq, Ministri i Drejtësisë në detyrë, Selim Selimi, ka potencuar se "ne si ministri kemi bërë ndryshim edhe në sistemin e Vettingut, të cilin e kemi bërë bashkë me juve. Ky Vetting do të jetë për ta mbrojtur ndershmërinë e prokurorit dhe për ta mbrojtur prokurorinë. Ne e kemi bërë edhe Rishikimin Funksional, një reformë e thellë në Sistemin e Drejtësisë, që prokurorisë do t'i jap forcë, pavarësi dhe punë".

Pjesëmarrësve në këtë konferencë me një fjalë rasti ju ka drejtuar edhe Ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, i cili, ka kërkuar nga prokurorët që të përqafojnë llogaridhënien duke iu përmbajtur standardit më të lartë ligjor dhe etik.

"Prokurorë, mbrojtës të viktimave dhe staf ndihmës – mbani në mend që publiku ju beson që të jeni prijës të sundimit të ligjit. Mos iu frikësoni llogaridhënies – përqafojeni atë. Kërkoni nga vetja, kolegët dhe prijësit tuaj që t'i përmbaheni standardit më të lartë ligjor dhe etik. Mbroni me forcë të drejtat e viktimat dhe siguroni dinjitet njerëzor për të akuzuarit. Kërkoni drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh pozita e tyre në shoqëri".

Në anën tjetër, Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se Prokuroria është një nga shtyllat kryesore të Sundimit të Ligjit. Sipas tij, krijimi dhe ruajtja e një prokurorie efikase, të pavarur dhe llogaridhënëse është proces i vështirë, kompleks dhe i vazhdueshëm. "E dimë mirë se në punën tuaj të përditshme si anëtarë të shërbimit të prokurorisë, ju përballeni me sfida të panumërta. Në përditshmërinë tuaj ju përballeni me Kufizimet prej pandemisë Covid19, presionin prej lëndëve të prapambetura, burimet e kufizuara njerëzore dhe financiare, zbatimin e Sistemit për Menaxhim Informativ të Lëndëve dhe ndryshimin e procedurave të punës, mungesën e stafit mbështetës, si dhe rastet e ndikimeve të

padrejta ndaj jush dhe lëndëve tuaja". Përkundër këtyre sfidave, ne vazhdojmë të besojmë në mundësinë e arritjes së rezultateve më të mira.

Duke folur për mbështetjen e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, ka thënë se është kënaqësi që të flas në këtë Konferencë Vjetore të Prokurorëve, me ç'rast ka lavdëruar Kryeprokurorin Lumezi për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Institutin e Bazelit.

"Zvicra beson se nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të z. Lumezi dhe Institutit të Bazelit për Qeverisje do të ndihmoj në përmirësimin e kapaciteteve hetuese të Kosovës. Do të doja të lavdëroj z. Lumezi për këtë iniciativë dhe për udhëheqjen e tij në këtë përpjekje".

Ndërkaq, Ambasadorja e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, Carin Lobbezoo, ndër të tjera ka deklaruar se i kupton plotësisht sfidat që vijnë në forcimin e mëtejshëm të sistemit të drejtësisë. "Shumicën e kohës nuk ka rregullime të shpejta ose zgjidhje të lehta. Por unë jam e bindur që me angazhimin dhe përkushtimin tuaj, është e mundur të krijoni një sistem efektiv dhe efikas të prokurorisë në të cilin çështjet e vështira si krimi i organizuar dhe korrupsioni i profilit të lartë mund të ndiqen me sukses".

Në këtë konferencë, përveç fjalimeve, janë mbajtur edhe prezantime mbi aktivitetet e rishikimit funksional, rolin e prokurorëve në politikën ndëshkimore, planin e veprimit të sistemit prokurorial gjatë pandemisë COVID-19 dhe për programin e bursave të Wake Forest.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Kërkohet paraburgim ndaj një personi për vrasje e rëndë dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve

Prishtinë, 28 janar 2021 – Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 27 janar 2021, me aktvendim të Prokurorit të Shtetit, ka ndaluar për 48 orë personin me inicialet S.K., dhe ndaj të njëjtit ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në drejtim të veprave penale "Vrasja e rëndë", nga neni 173 të KPRK-së dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 366 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Personi i lartcekur, dyshohet se më 27 janar 2021, rreth orës 17:00, me armë zjarri ka privuar nga jeta personin me inicialet A.K., (djalin e tij), në garazhin e objektit banesor të tyre, nga motive të panjohura deri më tani.

I dyshuari, me vendim të Prokurorit të Shtetit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh, ndërsa, trupi i pa jetë është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore, në Prishtinë, për obdukim.

Prokurori i Shtetit, në koordinim me Policinë e Kosovës, janë duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore lidhur me këtë rast.

AKTIVITETET E PROKURORIT TË SHTETIT
JANAR 2021

Kërkohet paraburgim ndaj një personi për pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare

Prishtinë, 31 janar 2021 – Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, më 30 janar 2021, ka ndaluar personin me inicialet H.K., zyrtar policor, i cili në vitin 2018, kishte keqtrajtuar një qytetar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. I njëjti është ndaluar, pasi dyshohet se ka kryer veprën penale "Pengimi i të provuarit apo

procedurës zyrtare", nga neni 386, paragrafi 1 pika 1.7 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Personi i lartpërmendur, dyshohet se pas lirimit nga ndalimi, ka penguar zhvillimin e të provuarit në procedurë, duke i bërë thirrje të dëmtuarit-dëshmitarit që ta tërheqë deklaratën e tij të dhënë në polici dhe duke i penguar hetimet.

Prokurori i Shtetit, ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit për të dyshuarin, në gjykatën kompetente.



PROKURORI I SHTETIT
DRŽAVNI TUŽILAC